



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
INSPEKTORATI QENDROR

URDHËR

Nr. 89 , datë 07/12/2017

“Për

**Zgjatjen e vlefshmërisë së kartës së inspektorit edhe gjatë vitit 2018, deri në
ristrukturimin e inspektorateve”**

Në zbatim të pikës 4, të nenit 30, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, kreut V, të vendim nr. 696, datë 16.8.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-inspektimi”:

URDHËROJ:

1. Zgjatjen e vlefshmërisë së kartës së inspektorit të prodhuar sipas Urdhrit Nr. 32/1, datë 15.07.2016, me periudhë vlefshmërie deri më 31.12.2017, edhe gjatë vitit kalendarik 2018, deri në ristrukturimin e inspektorateve.
2. Për çdo emërim të ri në detyrë, inspektori do të pajiset me kartën e inspektorit pranë Inspektoratit Qendror.
3. Ngarkohen Inspektorati Qendror dhe Inspektoratet Shtetërore për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ky urdhër dërgohet për botim në fletoren zyrtare, publikohet në faqen zyrtare të Inspektoratit Qendror www.insq.gov.al, si dhe ju njoftohet inspektorateve shtetërore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTOR I PËRGJITËSHËM
SHKËLQIM FAJDARI